Kronikë

# EMRAT/ Me armë e lidhëse në makinë për të marrë peng një 49-vjeçar, arrestohen 4 të rinj në Sarandë! Do ta rrëmbenin për një borxh të pashlyer

*Policia e Sarandës arrestoi 4 persona të cilët ishin të armatosur me pistoletë dhe kishin qëllim rrëmbimin e një 49-vjecari për një borxh të pashlyer. Policia ndaloi në rrugën Skënderbeu një automjet BMV ku ishin 4 të dyshuarit, brenda të cilit u gjetën një pistoletë, municione dhe lidhëse plastike që do shërbenin për të lidhur 49-vjecarin me banim në Sarandë.*

Redaksia
5 Janar, 11:53 | Përditësimi: 5 Janar, 13:01

Share

**VLORË**- Policia e Sarandës arrestoi 4 persona të cilët ishin të armatosur me pistoletë dhe kishin qëllim rrëmbimin e një 49-vjecari për një borxh të pashlyer.

Policia ndaloi në rrugën 'Skënderbeu' një automjet BMV ku ishin 4 të dyshuarit, brenda të cilit u gjetën një pistoletë, municione dhe lidhëse plastike që do shërbenin për të lidhur 49-vjecarin me banim në Sarandë.

Vëllezërit Juljan dhe Sandri Brinja, 27 dhe 28 vjeç, Gjergji Prenga 29 vjeç dhe një i ri grek, Angelos Tsimperis 20 vjeç u arrestuan nën akuzë për heqje të paligjshme të lirisë e mbetur në tentative dhe armë pa leje.

LEXO EDHE:
**Besimtarët ortodoksë kremtojnë ditën e Ujit të Bekuar**

*'Ditën e djeshme, në rrugën "Skënderbeu", në lagjen nr.1, shërbimet e Komisariatit të Policisë Sarandë, pas administrimit të informacionit, kanë ndërhyrë menjëherë duke ndaluar automjetin tip "BMW", me drejtues shtetasin Angelos Tsimperis dhe pasagjerë vëllezërit, Juljan dhe Sandri Brinja, 27 dhe 28 vjeç dhe Gjergji Prenga. Gjatë kontrollit në automjet, në vendin e pasagjerit ku qëndronte Juljan Brinja, shërbimet e Policisë gjetën 1 armë zjarri pistoletë dhe lidhëse plastike, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.*

*Në vijim të veprimeve procedurale u arrestuan në flagrancë Julian Brinja, Sandri Brinja, Gjergji Prenga dhe një i ri grek, Angelos Tsimperis 20 vjeç, për veprat penale "Heqja e paligjshme e lirisë", mbetur në tentativë, kryer në bashkëpunim dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve, armëve shpërthyese dhe municionit luftarak". Këta shtetas dyshohet se në kërcënimin e armës do të rrëmbenin një shtetas 49 vjeç, banues në Sarandë, për motive të dobëta. '- njofton policia.*

M.Q./Shqiptarja.com

TAG: pengmarrje | sarandë | gjergji prenga | sandri brinja | juljan brinja | Vlorë

Komento

## Komente

kicaqi: 05/01/2024 22:14

BMV eshte nisur nga Himara dhe deri ne Qafe Gjashta ne vendi pare ka qene nje polici me grada eshte i madhi ne himara Dhjonisi hoxha.ne borshi kane hipur dy persona.kaq per sot.

Përgjigju

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:**
**Gjobë qytetarëve për kalim të parregullt në rrugë, si e vlerësoni?**

Të drejtë | Të gabuar | Nuk e di

## Lajme të tjera

Tërmet në zonën kufitare Shqipëri – Greqi, lëkundjet ndihen fuqishëm në Konispol deri në Sarandë
5 Janar, 23:32

Kërcënuan 33 vjeçarin me armë zjarri, shpallen në kërkim tre të rinj në Vlorë
5 Janar, 18:03

Vlorë/ Gjendet e mbytur një grua në zonën e 'Ujit të Ftohtë' (VIDEO)
4 Janar, 09:29

Aksident në Vlorë, makina përplas 8 vjeçarin
3 Janar, 14:06

Festa në atdhe/ Emigrantët largohen pas festave, s'ka radhë në pikat kufitare
3 Janar, 10:51

Tenton të fusë kokainë në burgun e Vlorës, e kishte fshehur mes patateve
3 Janar, 10:06

Tentoi të godasë me shkelm një person, pezullohet nga detyra polici në Vlorë
2 Janar, 15:40

Vlorë/ Shisnin lëndë piroteknike, vihen nën hetim 2 persona, sekuestrohen fishekzjarre dhe kapsolla me vlerë rreth 800 000 lekë
2 Janar, 10:57

Gjashtë aksidente në rrugët e vendit në ditën e parë të vitit, dhjetë të lënduar! Faji i shoferëve
1 Janar, 22:50

TEC-et lundruese ankorohen prej një viti në Vlorë, por s'prodhojnë energji! Ende s'ka datë kur vihen në punë
1 Janar, 20:19

Incidentet natën e Vitit të Ri 2024/ Tiranë, plumbi qorr plagos italianen në bulevard! Në Vlorë 2 përfundojnë në spital
1 Janar, 11:50

Vlorë, dy persona përfundojnë në spital pas një sherri
1 Janar, 01:31



© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje